



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 11

Prishtinë, më 25. 07. 2011, në orën 10.00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi,
Albana Gashi, Ismet Beqiri, Kymete Bajraktari, Biserka Kostiq dhe Duda Balje.

Munguan: Justina Pula.

Të ftuar ishin: Ministri i Drejtësisë dhe ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale

Pjesëmarrës të tjerë: Isuf Zejna-KDI, Nuredin Ibishi - KFOS-CDF-UNDP, Elita Vokshi
– OSBE, Lejla Selimi-OSBE , Visar Bivolaku – EUSR dhe Ukë Gashi-ZPRK.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj- koordinator, Sulltane Gashi -
zyrtare ligjore dhe Burim Tahiri, praktikant.

Mbledhjen e drejtoi, Suazan Novoberdali – kryetare, e cila konstatoi se në bazë të
Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë plotësuar kushtet për mbajtjen e
mbledhjes dhe propozoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Takim me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, z.Hajredin Kuçi, si dhe ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, z.Nenad Rashiq lidhur me përmbushjen e planit të veprimtimit të Kuvendit të Kosovës për vitin 2011;
3. Shqyrtimi i Raport- informatës së Avokatit të Popullit;
4. Shqyrtimi i disa kërkesave;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2.Takim me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, z.Hajredin Kuçi, si dhe me ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, z.Nenad Rashiq lidhur me përmbushjen e planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për vitin 2011

Në këtë mbledhje ishin të ftuar ministrat e lartpërmendur që të marrin pjesë, por në mungesë të tyre, ftesës i janë përgjigjur zëvendësministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe zëvendësministri i Drejtësisë. Ata e informuan Komisionin lidhur me veprimet e ndërmarra për përmbushjen e pikave 40 dhe 41 të Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për vitin 2011.

Kryetarja - I përshëndeti të pranishmit dhe tha se sa i përket pikës 40 të Planit të Veprimit, fëmijët e pakicave ballafaqohen me rrezik dhe me një shkallë të përllëgoaritur të varfërisë prej 60%. Ajo ceku se skema e ndihmës sociale për zvogëlimin e varfërisë së fëmijëve nuk është miratuar, prandaj shumica e fëmijëve të varfër jetojnë në ekonomitë familjare që nuk marrin ndihmë sociale, dhe i bëri pyetje zëvendësministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale si vijon: A është duke u zbatuar Strategjia dhe plani i veprimit për të Drejtat e fëmijëve, cilat janë sfidat dhe perspektiva e zhvillimit? A është miratuar skema e ndihmës sociale me qëllim të zvogëlimit të varfërisë së ekonomive familjare që nuk marrin ndihmë sociale, a ka nevojë për mbështetje politike e financiare në zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e fëmijëve? Ajo e ftoi zëvendësministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale që ta marrë fjalën.

Z.Fatmir Shurdhaj-Pasi e përshëndeti Komisionin, iu përgjigj pyetjeve të parafolësës dhe shtoi: Ligji nr. 2003/15 për skemën e Ndhimës sociale në Kosovë

u ofron ndihmë dhe përkrahje financiare familjeve të varfra në Kosovë me qëllim të zbutjes së varfërisë, prandaj kjo skemë u dedikohet të gjithëve pa dallime etniteti, pra për çdo familje e cila i plotëson kushtet për ndihmë sociale.

Ai më tutje tha se të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh identitetin e tyre, mund të aplikojnë për fitimin e kësaj të drejte tek QPS në komunat përkatëse në Kosovë.

Aktualisht në Kosovë kemi 40 QPS, dhe shumica mujore e ndihmës sociale sillet prej 40 deri në 80 euro në muaj, kohëzgjatja e ndihmës sociale është për gjashtë muaj me mundësi vazhdimi përmes aplikimit në skemën për ndihmë sociale.

Gjatë diskutimit bëri një përmbledhje të shkurtër të aktiviteteve që ka ndërmarrë ministria dhe i njoftoi të pranishmit me të arriturat e kësaj ministrie për zvogëlimin e varfërisë dhe përmirësimin e kushteve të fëmijëve. Pas diskutimit, deputetët i shtruan pyetje si në vijim:

Albana Gashi - Kemi disa informata prej policisë se punëtorët socialë nuk dalin në terren jashtë orarit të punës dhe ndodh shumë herë që një i mitur viktimë e dhunës në familje, të qëndrojë gjatë natës në stacion të policisë pa shoqërimin e punëtorit social dhe ai mund të fitojë trauma psikike, sepse punëtorët socialë nuk janë të pranishëm pasi që nuk paguhet jashtë orarit të punës?

Rita Hajzeraj- Nëse punëtorët socialë nuk lajmërohen me telefon nga policia, a keni ndonjë procedurë tjetër që ka paraparë ministria juaj që për të lehtësuar dhe për të zgjidhur këtë problem, duke pasur parasysh se ka shumë raste të tilla që ndodhin në këto qendra?

Ismet Beqiri- Pyeti se a ka orar të punës mbas orës 16:00, nëse nuk ka orar shtesë mbas orës 16:00, si trajtohen ata njerëz, a e shqyrton mundësin ministria për të pasur orar të zgjatur sepse nëse nuk është e përcaktuar, nuk punojnë pavarësisht se kush e bën kërkesën?

Kymete Bajraktari- Çka bëhet me fëmijët që janë trafikuar, dhe nëse ata gjinden, çfarë bëhet me ata fëmijë, si bëhet rehabilitimi dhe trajtimi i tyre?

Rita Hajzeraj- Sërish i bëri pyetje: A dalin ndonjëherë inspektorët e mirëqenies sociale në terren për të vëzhguar se sa fëmijë punojnë pa e mbushur moshën dhe kriteret për punë, sa dalin inspektorët në terren, cilat janë rezultatet, a keni numër të saktë të atyre që i detyrojnë fëmijët për të punuar sepse ka raste fëmijët shtyhen nga personat e rritur për të punuar, apo për t'i parë kushtet e familjes së atij fëmije për të parë se çka e shtyn fëmijën që të punojë, a keni ndërmarrë masa që familjes t'i ofroni diçka si kompensim që fëmija mos të punojë?

Suzan Novoberdliu – Pyeti sa anëtarë të familjes duhet të jenë për t'i marrë familja 40 euro dhe sa anëtarë duhet t'i ketë familja për t'i marrë i marrë 80 euro, dhe u tha që familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara, i marrin 100 euro, a keni nevojë për rritje të përkrahjes financiare dhe politike, si dhe skemën sociale e cila nuk është miratuar, sa e parasheh kjo skemë sociale zbutjen e varfërisë së ekonomisë familjare?

Fatmir Shurdhaj- Iu përgjigj të gjithave pyetjeve të parashtrua dhe nuk pati vërejtje nga ana e parashtruesve, për çka Komisioni e falënderoi atë lidhur me punën që është duke bërë kjo ministri.

Kryetarja- Para se t'ia japë fjalën zëvendësministrit të Drejtësisë, i kërkoj sqarime shtesë se sa po zbatohet Kodi penal i drejtësisë për të mitur dhe sa janë të garantuara dhe të zbatueshme të Drejtat e fëmijëve, prandaj e ftoj zëvendësministrin që të marrë fjalën.

Z. Daut Xhemajli- Tha se lëmi i të Drejtave të fëmijëve është i gjerë dhe përveç Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, me këtë çështje merren edhe autoritete të tjera, pra me këto të drejta.

Ai në vazhdim ceku se Ministria e Drejtësisë ka një mekanizëm shumë të suksesshëm për shërbimin provues, i cili mbikëqyrë zbatimin e masave alternative për kryerësit e mitur të veprave penale të shqiptuara nga organet kompetente të drejtësisë. Pra, Ministria e Drejtësisë ka ndërmarrë edhe një varg hapash për trajtimin sa më të mirë të dënuarve të mitur me burgim, kësaj kategorie u njihet e drejta e shkollimit dhe aftësimit profesional me qëllim të riintegrit të tyre të suksesshëm në jetën post penale, kemi themeluar Këshillin drejtues për reformimin dhe monitorimin e sistemit të drejtësisë për të mitur.

Shërbimi provues i Kosovës në kontekstin e zbatimit të Kodit penal për të mitur, qysh me iniciimin e procedurës ndaj të miturit, me kërkesë të prokurorisë, ka hartuar anketa sociale.

Ai i njoftoi edhe me punët e tjera që kryhen në këtë ministri lidhur me të Drejtat e fëmijëve.

Kryetarja- I ftoj anëtarët për të paraqitur pyetje, nëse dëshirojnë.

Kymete Bajraktari- Tha se çka ndodh me prindërit që ushtrojnë dhunë ndaj fëmijëve dhe a u merret e drejta e kujdestarisë?

Rita Hajzeraj- Ka raste kur personat madhorë i shtyjnë fëmijët të kryejnë vepra penale vjedhje, dhe pasi këta fëmijë mbahen në paraburgim për kohë të caktuar, lirohen pa u dënuar me arsye se janë të mitur dhe prapë vazhdojnë të kryejnë vepra penale.

A keni paraparë ju si ministri të ndërmerreni masa që këto raste të mos ndodhin dhe fëmijët mos t'i përsërisin veprat penale?

Suzan Novoberdaliu – kryetare, pyeti: Pse ndodh që personat madhorë i shtyjnë fëmijët në kryerjen e veprave penale, mendoj se vjen si pasojë e varfërisë dhe si përfundim mund të themi se kjo dukuri mund të zvogëlohet me rritjen e zhvillimit ekonomik?

Pyetjeve të shtrura iu përgjigj zëvendësministri dhe e falënderoi Komisionin për prezantimin dhe punën që është duke bërë kjo ministri.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur, më 5 korrik 2011

Pas vërejtjeve që pati Biserka Kostiq, lidhur me materialin, si dhe ftesat e procesverbalin që nuk po i procedohen në gjuhën serbe.

Kryetarja i propozoi Komisionit që procesverbali të hiqet nga rendi i ditës dhe i njëjti t'i ofrohet parafolëses në gjuhën amtare.

3.Shqyrtimi i raport- informatës së Avokatit të Popullit

Kryetarja tha se Avokati i Popullit, ka bërë disa vërejtje rreth zhvillimit të punës së tij, e që lidhen me kërkesat buxhetore, si dhe rreth pavarësisë së tij kushtetuese.

Ajo tha se lidhur me këtë raport janë të njoftuar Qeveria, Kryesia e Kuvendit të Kosovës, prandaj Komisioni ka mandatin të shqyrtojë vetëm brenda fushë veprimtarisë së tij.

Të ndryshme

Kryetarja- Komisionin e informoj me punën që është duke bërë grupi punues rreth seleksionimit të dokumentacionit të kandidatëve për zëvendësit dhe i njoftoi me përgjegjësinë se Komisioni nuk është kompetent të bëjë intervistimin e kandidatëve, por vetëm përzgjedhjen e dokumentacionit të tyre.

Komisioni nuk shqyrtoi kërkesat sipas pikës së katërt të rendit të ditës dhe vendosi që të njëjtat të shqyrtohen në mbledhjen e ardhshme.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdaliu